



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:159868  
Datë: 06.06.2024  
Numri i dokumentit: 05788656

**P.nr.2023/159868**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B.H për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, ndërsa sipas aktakuzës PP.nr.1879/22 të dt.20.09.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt. 31.05.2024, ku prezent ishin Prokuroria e shtetit Uridia Caka, i akuzuari B.H me mbrojtësin e tij av.J.B i angazhuar sipas detyrës zyrtare dhe e dëmtuara-mitura V.L me përfaqësuesin e saj ligjor prindin E.L, me dt.04.06.2024, shpallë, ndërsa me dt.06.06.2024, e përpilon këtë:

## A K T G J Y K I M

**I AKUZUARI: B.H**, nga i ati A dhe e ëma S e lindjes D, i lindur më datën data..., në Rahovec ku edhe jeton, me nr. personal:....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i ati i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se me datë 09.12.2022, rreth orës 16:40 min, në Rahovec, nga pakujdesia rrezikon trafikun publik duke vepruar në kundërshtim me nenin 53 par.1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor nr.05/L-088 edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se me një veprim të tillë do të vjen deri te pasoja e ndaluar, lehtas e ka marrë se gjerë tek ajo nuk do të vjen apo në momentin e duhur do ti shmanget dhe me këtë i shkakton lëndime të rënda trupore të dëmtuarës së mitur V.L, në atë mënyrë që ditën kritike derisa i pandehuri B.H ishte duke drejtuar automjetin e tipit W me targa targa..., nuk e përshtatë shpejtësinë e lëvizjes, kushteve e rrethanave në rrugë dhe me të arritur ne vendin e lartë cekur, me pjesën e përparme të anës së djathtë të automjetit të tij e godet të dëmtuarën e cila ishte me disa nxënës tjerë duke e kaluar rrugën nga ana e djathtë në të majtë të drejtimit të lëvizjes, ku nga goditja të dëmtuarës i shkakton lëndime të rënda trupore të përshkruara si në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr.F.B të datës 17.012023.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43 69, dhe nenin 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovë të njëjtin e:

## G J Y K O N

Ashtu që e gjykon me dënim burgimi me kusht në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muajve**, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej **1 (një) viti**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

**URDHËROHET** Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjakovë që ta mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë dënimin me kusht, ashtu që **OBLIGOHET** i akuzuari që të mbajë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në Gjakovë.

Obligohet i akuzuarit në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumen prej 20 euro, ndërsa 20 € për programin për kompensimin e viktimave të krimit, ndërsa shpenzime të procedurës penale shumën prej 60, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të bëhet me detyrim.

E dëmtuara V.L, lidhur me kërkesën pasurore-juridike udhëzohet në kontestin civil.

## A r s y e t i m

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1879/2022 të dt. 20.09.2023, e ka akuzuar B.H, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 31.05.2024, ku prezent kanë qenë, prokuroria e shtetit Uridia Caka, i akuzuari B.H me mbrojtësin e tij av.J.B dhe e dëmtuara-mitura V.L me përfaqësuesin e saj ligjor prindin E.L, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari B.H pas konsultimit paraprak me mbrojtësin e tij në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se me vije keq për rastin i cili ka ndodhur për të cilin jam penduar thellë ,por natyrisht qe kjo ka ndodhur pa vullnetin tim, nga pakujdesia, këtu të dëmtuarës dhe prindit të saj i kërkoj falje dhe të njëjtën kohë jam falënderues shumë ndaj familjes se të dëmtuarës që nga dita parë me kanë pritur në familje,ky ka qenë rasti im i parë që kam ra ndesh me ligjin andaj kërkoj nga gjykata që ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese në rastin e shqyrtimit të dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.J.B ka deklaruar: pas konsultimit paraprak me të mbrojturin tim duke ja shpjeguar efektet dhe benefitet e pranimit të fajësisë i njëjti në mënyrë vullnetare e pranoj fajësinë, andaj kërkoj nga gjykata që të aprovohet pranimi i fajësisë, po ashtu kërkoj nga gjykata që në rastin e caktimit dhe matjes të dënimit ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese, siç janë pranimi i fajësisë, për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, kërkim falja, po ashtu i mbrojturi im premtun që në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm që mos të bije ndesh me ligjin dhe të mos kryej kurrfarë vepre penale.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuares V.L prindi E.L deklaron:nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, nuk i bashkangjitem ndjekjes penale,ndërsa parashtojme kërkesë pasurore juridike ndaj kompanisë së sigurimit përkatës, po ashtu deklaroj se që nga momenti kur ka ndodhur aksidenti i akuzuari është interesuar dhe i njëjti ka ardhur në familje ku është interesuar për vajzën time të dëmtuarën në këtë aksident.

Prokuroria e shtetit Uridia Caka në shqyrtimin fillestar ka deklaruar: Nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari dhe se pranimi i fajësisë meqenëse i njëjti pranimin e ka bere në menyrë vullnetare pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij duke i ditur natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë si dhe pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes në provat materiale dhe personale në bazë të cilave është ngritur aktakuza e cila nuk përmban shkelje ligjore apo gabime faktike andaj i propozoj gjykatës që ta aprovojë pranimin e fajësisë,si dhe me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit propozoj që për këtë të akuzuar si rrethane lehtësuese ti merret pranimi i fajësisë ndërsa si rrethane renduese intensiteti dhe apo rrezikimi apo dëmtimi i vlerës së mbrojtur ktu jetës dhe trupit të viktimës së mitur si dhe po ashtu të merret si rrethanë renduese rrezikshmëria shoqerore e kësaj vepre penale.

## 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-se i akuzuari B.H nga pakujdesia ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Raporti i hetuesit mbi vend-shikimin e aksidentit, dt.09.12.2022;
- Raporti i aksidentit nr. 2022-ER-787, dt.09.12.2022;
- Raportet mjekësore në emër të dëmtuarës me numër protokollit 984 i dt.09.12.2022 i lëshuar nga QKMF Rahovec si dhe 17460 i dt.09.12.2022 i lëshuar nga Spitali Rajonal në Gjakovë;
- Akt ekspertimi mjeko-ligjor i punuar nga Dr.F.B, dt.17.01.2023;
- Ekspertiza e aksidentit të trafikut i dt.31.01.2023, i punuar nga eksperti i komunikacionit B.P;
- Deklarata e të dëmtuarës V.L, e dhënë në polici me dt.11.12.2022;
- Deklarata e të pandehurit B.H, e dhënë në polici me dt.09.12.2022 dhe në prokurori me dt.28.07.2023;
- Fotografitë dhe shkresat tjera në lëndë.

#### 4. Elementet e veprës penale.

Në nenin 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, është parashikuar se: *Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet lidhur me Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit dhe Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*

#### 5 Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin B.H e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik sipas nenit 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

#### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së (kodi nr. 06/L074), të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë, për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, i gjendjes së dobët ekonomike, mbajtës i familjes 8

anëtarëshe me një rrogë prej 400 euro në sektorin privat, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej kurrfarë vepre penale, kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese

gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin **burgimi me kusht** në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muajve**, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej **1 (një) viti**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, mund të arrihen qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi udhëzimin në kontestin civil

Vendimi mbi udhëzimin në kontestin civil është marr konform nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.2023/159868, me dt.04.06.2024.**

Sekretarja juridike  
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Lulzim Paçarizi

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.